



**RAPORT  
MONITORIMI I SEKTORIT TË  
MJEDISIT NË KOMUNËN E  
JUNIKUT**

**2024**

**MAJ, 2025**



# **RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E JUNIKUT – 2024**

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr. 67, Prizren,  
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)  
[info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

029 222 771

Maj, 2025

# **PËRMBAJTJA :**

## **HYRJE**

## **GJETJET E RAPORTIT**

- 1 Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor  
Statistikat Kryesore - 2024:**
- 2 Korniza ligjore**
- 3 Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit**
- 4 Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor  
Raportet mjedisore në nivelin lokal**
- 5 Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave**
- 6 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike**
- 7 Licencimi dhe lejet mjedisore**
- 8 PËRFUNDIME**
- 9 REKOMANDIMET**

# HYRJE

Ky raport është një përpjekje e re e strukturuar e shoqërisë civile për të adresuar e trajtuar përgjegjësitë e organeve kompetente të Qeverisë Lokale, përkatësisht përgjegjësitë e Komunave karshi 7 aspekteve mjedisore që rregullohen me kornizën ligjore të vendit.

Organet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit janë të rregulluara në forma të ndryshme në Komunat e Kosovës. Disa nga komunat kanë drejtori të dedikuara për mbrojtjen e mjedisit, ndërsa disa kanë sektore në kuadër të drejtorive për planifikim apo zyrtarë përgjegjës për çështje mjedisore.

Metodologjia e ndjekur nga EC Ma Ndryshe për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

- Ligji nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit
- Ligji nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës
- Ligji nr.03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
- Ligji nr.2003\_3 për pyjet e Kosovës
- Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës
- Ligji nr.04/L-060 për mbeturina
- Ligji nr.06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike
- Ligji nr.03/L-119 për produktet biocide dhe shtojcat
- Ligji nr.02/L-53 për gjuetinë
- Ligji nr.04/L-197 për kimikate
- Ligji nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor
- Ligji nr.04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Mbi këtë bazë përmbajtja e këtij raporti tenton që të mbulojë aspektet kryesore që legjislacioni në fuqi adreson, si:

- Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
- Korniza ligjore
- Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit
- Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
- Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave
- Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike
- Licencimi dhe lejet mjedisore

Gjetjet e këtij raporti në kapituj të caktuar kanë identifikuar mangësitë aktuale në sektorin e mjedisit, që kërkojnë vëmendje më të shtuar nga autoritetet komunale, me qëllim të përmirësimit të procesit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor. Gjithashtu ato janë validuar nga zyrtarët përkatës komunal, si pasqyrim i gjendjes reale në sektorin e mjedisit.

Në fund janë adresuar edhe disa rekomandime me qëllim të përmirësimeve dhe plotësimeve në proceset e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor, drejt arritjes së rezultateve më të qëndrueshme në sektorin e mjedisit dhe mbrojtjen e resurseve natyrore.

## GJETJET E RAPORTIT

### Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Junikut organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Drejtoria Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Sipas deklaratave të zyrtarëve të DUKM-së në kuadër të kësaj drejtorie nuk ka sektor sa i përket fushës së mjedisit teksa nuk është raportuar numri i stafit të angazhuar.

Organi komunal	A është themeluar?	Emri zyrtar	Fuqia aktuale punëtore
Drejtoria	Po	Drejtoria për Shërbimeve Publike dhe Mjedisit	/
Spektori	Jo	Spektori i Mjedisit	1
Zyrtarët	Jo	Adnan Bullatovci Ejup Qyqalla	2
Drejtoria	Po	Drejtoria e Inspeksionit	/
Spektori	Po	/	/
Zyrtarët		Faton Berjani	1

Numri i angazhuar i shërbyesve civil në këtë drejtori thuhet se nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore. Ndërsa, sa i përket pyetjes se a kanë shërbyesit civil profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave, zyrtarët e DUKM dhe DShPIMSh kanë thënë kanë profilet e nevojshme profesionale. Njëkohësisht përgaditja e tyre profesionale nga nga shkalla 1 (aspak) deri në 5 (shkëlqyeshëm) është vlerësuar me numrin 3 nga DUKM dhe 5 nga DShPIMSh.

DUKM dhe DShPIMSh kanë bërë të ditur se gjatë vitit 2024 për punonjësit e këtij sektori janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore dhe rreth çështjeve mjedisore nga GIZ dhe një punëtori nga REC mbi nevojat për hartimin e Planit Lokal për Veprimin në Mjedis.

Stafi i DUKM gjatë vitit 2024 si udhëzues profesional për planifikimin dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore përdor vetëm Udhëzimin Administrativ për Lejet Mjedisore Komunale, po ashtu është raportuar se gjatë kryerjes së detyrave kryesisht kjo drejtori është fokusuar në legjislacionin në fuqi dhe dokumentet strategjike për të cilat janë të obliguar t'i zbatojnë.

### Statistikat Kryesore - 2024:

Kategoritë	Numri
Numri i zyrtarëve të angazhuar në DShPIMSh	/
Trajnimet rreth kornizës ligjore	0
Trajnimet sipas fushës mjedisore	2
Udhëzues Profesional për Planifikimin dhe Menaxhimin Mjedisor	1

## **Korniza ligjore**

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Junikut , përkatësisht DUKM dhe DShPIMSh ka raportuar se mbështetet në këto dokumente ligjore:

- 1.Ligjin për Planifikim Hapësinor
- 2.Ligjin Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit
- 3.Ligjin Nr. 02/L-30 për Menaxhim të Mbeturinave
- 4.Ligjin 04/L-175 për Inspektim
- 5.Ligjin Nr. 03/L-024 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- 6.Ligjin Nr. 03/L-015 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor
- 7.Ligji Nr.02/L-102 Ligji për Mbrojtje nga Zhurma
- 8.Ligji Nr. 03/L-160 Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja,
- 9.Ligjin Nr.04/ L-147 për Ujëra, etj.,

Ndërsa në kuadër të Udhëzimeve Administrative shfrytëzohen:

- 1.U.A Nr.01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale,

Zyrtarët e DUKM kanë vlerësuar se korniza ligjore është pjesërisht e konsoliduar dhe kanë vlerësuar me 3 njohuritë e stafit rreth kornizës ligjore (1/aspak -5/shkëlqyeshëm). Teksa, zyrtarët e DShPIMSh kanë vlerësuar se korniza ligjore është mirë e konsoliduar dhe kanë vlerësuar me 5njohuritë e stafit rreth kornizës ligjore (1/aspak -5/shkëlqyeshëm).

## **Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit**

Gjatë vitit 2024 DUKM dhe DShPIMSh kanë theksuar se si dokument për planifikim dhe menaxhim mjedisor ka Planin Lokal të Veprimit plan i cili ka skaduar dhe Rregulloren Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave.

Sa i përket harmonizimit të këtyre strategjive lokale me strategjitë qendrore zyrtarët kanë treguar se ato janë të harmonizuara. Ndërsa mbi projektet kapitale të nivelit lokal për rregullimin, promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit zyrtarët e të dy drejtorive kanë përmendur vendosjen e konteinerëve në hapësira publike, furnizimi me komposterë për ekonomitë familiare, vendosja e konteinerëve për ndarjen e mbeturinave

në hapësira publike, mirëmbajtja e lumit Erenik dhe aksione për pastrimin e disa hapësirave publike të Junikut.

Sa i përket masave të ndërmarra nga ana e nivelit lokal për mbrojtjen e mjedisit, zyrtarët kanë thënë se nuk janë ndërmarrë masa të tilla, përveç shqiptimit të disa gjobave për të cilat nuk janë dhënë më shumë informacione.

## **Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor**

Zyrtarët e DShPIMSh kanë raportuar se po realizohet inspektimi i kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit. Në të njëjtën kohë ata kanë treguar se hartohen raporte të inspektimit mjedisor, por nuk hartohen raporte të monitorimit të zbatimit të strategjive mjedisore në mungesë të sektorit dhe zyrtarit/es mjedisore në komunën e tyre.

Sa i përket gjendjes së deponive zyrtarët kanë pohuar se deponitë monitorohen në mënyrë sistematike dhe se realizohen vlerësime të ndikimit të tyre në mjedis.

Në pyetjen mbi identifikimin e çrregullimeve mjedisore, zyrtarët kanë treguar se janë identifikuar raste nga kërkesat e pranuar nga qytetarët (verbale dhe zyrtare) për çështje mjedisore, si dhe kanë përmendur se kanë pasur një rast gjatë këtij viti, rast ky i cili është proceduar në polici. Ndërsa sa i përket identifikimit të shkeljeve në menaxhimin e burimeve drusore, jodrusore dhe faunës së egër dhe tejkalimeve të kushteve të vendgjutive nga zyrtarët është raportuar se nuk evidentuar raste të tilla.

Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemi të menaxhimit të dhënave Komuna e Junikut nuk ka sisteme të monitorimit të cilësisë së ajrit, dheut, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore teksa në lidhje me mbikëqyrjen sistematike të cilësisë së ujit është raportuar se kjo procedurë realizohet nga ana e Kompanisë Rajonale "Hidrodrini".

Përgjatë vitit 2024 Komuna e Junikut nuk ka pasur sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore si shkak kjo nga mungesa e sektorit për mbrojtjen e mjedisit. Po ashtu sa i përket posedimit të kapaciteteve të nevojshme teknike për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore ata vlerësojnë se nuk ka as staf e as kapacitete për grumbullimin dhe menaxhimin e tyre.

Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Junikut bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore dhe hartimin e strategjive mjedisore e kanë lërsuar mesatarisht të kënaqshëm.

Sipas tyre niveli i bashkëpunimit me organizatat joqeveritare sa i përket zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme është po ashtu në nivel të kënaqshëm, ku janë përmendur bashkëpunimi me REC për hartimin e PLVM-së dhe me Pro Planning me të cilin është zhvilluar udhërrëfyesi për pjesëmarrjen publike në Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Planet Hapësinore dhe Urbane. Pjesëmarrjen publike të cilën zyrtarët e kanë vlerësuar mesatarisht të kënaqshme gjatë diskutimeve publike që kjo komunë ka realizuar gjatë hartimit të PLVM-së, rregullores komunale dhe planit komunal për menaxhimin e mbeturinave.

### **Licencimi dhe lejet mjedisore**

Sa i përket lejeve mjedisore në kuadër të DShPIMSh zyrtarët kanë raportuar se kanë lëshuar gjithsejt 3 leje dhe licenca mjedisore komunale.

### **PËRFUNDIME**

Gjetjet e këtij raporti janë validuar nga zyrtarët përkatës komunalë, duke pohuar se ato pasqyrojnë gjendjen reale në sektorin e mjedisit, bashkë me mundësitë për të ngritur dhe përmirësuar çështjet mjedisore në këtë komunë. Mungesa e sektorit për mjedis së bashku me burimet njerëzore dhe financiare që sipas tyre nuk janë të nivelit të mjaftueshëm, po reflektohet edhe në gjendjen aktuale mjedisore.

Komuna e Junikut nuk ka një organ përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit dhe kapacitetet njerëzore brenda këtij organi janë të pamjaftueshme duke shtuar se në periudhën raportuese nuk është organizuar dy trajnime rreth çështjeve mjedisore për stafin e DUKM dhe DShPIMSh.

Zyrtarët e DUKM kanë vlerësuar se korniza ligjore është pjesërisht e konsoliduar dhe kanë vlerësuar me 3 njohuritë e stafit rreth kornizës ligjore. Teksa, zyrtarët e DShPIMSh kanë vlerësuar se korniza ligjore është mirë e konsoliduar dhe kanë vlerësuar me 5 njohuritë e stafit rreth kornizës ligjore.

Shkalla e hartimit dhe zbatimit të politikave lokale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor mbetet problematik, për faktin se nuk ka organizim të mirëfilltë në këtë aspekt; përkatësisht, rrjedha aktuale e hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit aktualisht e bën të vështirë matjen e efikasitetit të këtyre veprimeve në përmirësimin e gjendjes mjedisore.

Niveli i inspektimit dhe monitorimit mjedisor mbetet i paqartë, megjithëse raportohen inspektime të shkeljeve mjedisore.

Komunën e Junikut ende nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore, për shkak të mungesës së sektorit, mungesës së resurseve teknike dhe njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Bashkëpunimi ndërinstitucional në hartimin e politikave publike vlerësohet të jetë i nivelit mesatar njësoj si bashkëpunimi me aktivistët e shoqërisë civile dhe se pjesëmarrja publike zhvillohet vetëm gjatë hartimit të PLVM-së, rregullores komunale dhe planit komunal për menaxhimin e mbeturinave. Kësisoj bashkëpunimi me shoqërinë civile në hartimin e politikave lokale mbetet i kënaqshëm, kesisoj vlerësohet dhe pjesëmarrja e publikut në hartimin strategjive lokale.

Sa i përket lejeve mjedisore në kuadër të DShPIMSh zyrtarët kanë raportuar se kanë lëshuar gjithsejt 3 leje dhe licenca mjedisore komunale.

## REKOMANDIMET

- Të shqyrtohen mundësitë për shtimin e një sektori për mbrojtjen e mjedisit në DUKM;
- Të shqyrtohen mundësitë për shtimin e punonjësve profesionistë në DUKM & DShPIMSh;
- Të organizohen më shumë trajnime për punonjësit e DUKM & DShPIMSh rreth kornizës ligjore dhe rreth çështjeve mjedisore;
- Të përmirësohet dhe dinamizohet hartimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit;
- Planet e nivelit lokal për menaxhimin mjedisor të përditësohen, bashkë me fuqizimin e raportimit të zbatimit të tyre;
- Të rriten kapacitetet si dhe të shtohet mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor;
- Të fillojë sa më shpejtë procesi i krijimit, grumbullimit, menaxhimit të të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të të dhënave mjedisore;
- Të avancohet bashkëpunimi nivel qendror - lokal në hartimin e akteve ligjore dhe strategjive mjedisore; dhe
- Të kultivohet bashkëpunimi më i afërt me OJQ-të për të nxitur rritjen e pjesëmarrjes së publikut në çështjet mjedisore;

## **Për EC:**

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse.

Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar.

Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-së synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.

## **Deklarata e vizionit**

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

## **Deklarata e misionit**

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.